



Sheshi "Erhard Busek", nr. 12, Prishtinë | Tel. fax: +383 38 248 940, +383 38 212 416
email: info.bkk@rks-gov.net | Ueb: www.biblioteka-ks.org

Bazuar në Ligjin e Punës nr. 03/L-212, nenin 80 dhe 81 dhe nenin 89 të Ligjit për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës nr. 08/L-197, Ligjin nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Ligjin nr. 04/L-097 për Bibliotekat, Statutin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani" dhe Udhëzimin Administrativ MFPT nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani" shpall:

Konkurs

Institucioni: Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

Titulli i punës: Udhëheqës i Divizionit të Bibliotekës Digjitale

Kategoria funksionale: Krijues/ dhe performues/e/artit dhe kulturës - drejtues i ulët

Klasa e pozitës: K5

Koeficienti: 9.5

Nr. i kërkuar: 1

Kohëzgjatja e emërimit: Me mandat 4-vjeçar

Data e njoftimit: 17.09.2025

Afati për aplikim: 19.09.2025-20.10.2025

Numri i referencës: RN00018698

Kodi: RP0012237

I përgjigjet: Drejtorit të Departamentit të Shërbimit të Përdoruesve dhe Zhvillimit Profesional

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Udhëheq, organizon dhe mbikëqyr aktivitetet e Divizionit të Bibliotekës Digjitale.
- Hartuar dhe zbaton politikat për digjitalizimin e koleksioneve bibliotekare.
- Siguron ruajtjen, përpunimin dhe qasjen online në koleksionet digjitale.
- Hartuar dhe realizon projekte zhvillimore për shërbimet digjitale të bibliotekës.
- Bashkëpunon me institucionet kombëtare e ndërkombëtare për zhvillimin e digjitalizimit.
- Monitoron standardet teknike dhe profesionale në procesin e digjitalizimit.
- Ushtron detyra të tjera sipas kërkesës së Drejtorit të Departamentit.

Kriteret e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi sipas ligjit;
- Ta njohë së paku njërën nga gjuhët zyrtare;
- Të jetë i aftë shëndetësisht dhe profesionalisht për detyrën;
- Të mos jetë i dënuar me dashje për vepër penale;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Ta ketë arsimimin, përvojën profesionale dhe aftësitë e kërkuara;
- T'i kalojë me sukses procedurat e pranimit.

Kriteret formale dhe specifike

Arsimimi: Diplomë e arsimit të lartë (niveli i parë - Bachelor) në bibliotekonomi, shkenca të informimit, teknologji të informacionit ose fusha përkatëse.

Përvoja e punës : Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.

Aftësi dhe njohuri:

- Njohuri të thella profesionale në bibliotekonomi dhe/ose teknologji të informacionit;
- Përvojë në projekte të digjitalizimit dhe arkivimit elektronik;
- Aftësi në menaxhim të projekteve dhe të burimeve njerëzore;
- Aftësi kërkimore, analitike dhe vlerësuese;
- Njohuri të gjuhëve të huaja – përparësi gjuha angleze (nivel profesional).

Dokumentet e nevojshme:

1. Letërnjoftim/pasaportë;
2. Diplomë e noterizuar dhe, nëse është e huaj, akti i nostrifikimit ose vërtetimi i procedurës së nostrifikimit;
3. Dëshmi për përvojën e punës (kontratë ose vërtetim);
4. Dëshmi që nuk ka masë disiplinore në institucion publik;
5. Certifikatë mbi dënimet penale jo më e vjetër se 6 muaj;
6. Dëshmi për trajnime të ndjekura ose të realizuara;
7. Dokumente shtesë që provojnë plotësimin e kushteve të shpalljes.

Akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Bazuar në Ligjin e Punës nr. 03/L-212, nenin 80 dhe 81 dhe nenin 89 të Ligjit për Zyrtarët Publikë të Republikës së Kosovës nr. 08/L-197, Ligjin nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Ligjin nr. 04/L-097 për Bibliotekat, Statutin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani” dhe Udhëzimin Administrativ MFPT nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.

Procedurat e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Paraqitja e kërkesave: Të interesuarit mund t'i dorëzojnë kërkesat e tyre dhe dokumentacionin në zyrën nr. 23, kati I, nga ora 09:00-12:00, apo përmes postës në adresën: Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”, Zyra e Personelit, nr. 23 (aplikim për punë), Sheshi “Erhard Busek”, nr. 12, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët

Data e njoftimit për aplikim në uebfaqen unike të procedurave të konkurrimit <https://konkursi.rks-gov.net> është nga data 19.09.2025, deri me datë 20.10.2025.

Përveç uebfaqes unike të procedurave të konkurrimit, konkursi publikohet edhe në uebfaqen e BKK-së.

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani” ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në Shërbimin Civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret në uebfaqen www.biblioteka-ks.org dhe dorëzohet në Zyrën nr. 23, kati I, nga ora 09:00-12:00, apo përmes postës në adresën: Biblioteka

Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”, Zyra e Personelit nr. 23 (aplikim për punë), Sheshi “Erhard Busek”, nr. 12, 10000, Prishtinë, Kosovë.

“Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen”.

Kandidati përmes aplikacionit deklaron dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e procedurës së rekrutimit.

Deklarimi i rrejshëm sipas këtij neni paraqet shkas për përjashtim nga procedura e rekrutimit.